



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**

**GJITHE DEGEVE DOGANORE**  
**GJITHE DREJTORIVE PRANE DPD-SE**

**MANUAL**

Nr. 15863 Prot., date 29.09.2012

Mbi perdorimin e disa kodeve shtese, kode procedure te zgjeruar dhe njesive plotesuese ne DAV

Ne zbatim te Ligjit nr 61/2012 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", me qellim aplikimin e niveleve te akcizes sipas ketij ligji, ne Sistemin Asycuda World jane shtuar disa kode shtese, kode procedure te zgjeruar dhe njesi plotesuese. Per sa me siper gjate plotesimit te deklarates doganore duheet te mbahen parasysh rastet si me poshte.

A. Kode shtese

I. Per kategorine e mallrave te meposhteme, ne kutine 37b do te vendosen kodet shtese te percaktuara ne tabelen e meposhtme:

| Kategoria<br>(sipas shtojces 1 te Ligjit te Akcizes 61/2012)            | Kodi shtese qe duhet<br>te vendoset ne<br>kutine 37b |
|---|--|
| W200<br>Vera e qete dhe pijet e qeta te fermentuara                     | W20  |
| W300<br>Vera spumante, Shampanja dhe pijet e fermentuara dhe te gazuara | W30  |
| I000<br>Pijet alkoolike te ndermjetme                                   | 100  |
| S200 -<br>Pije lkolike (Spirituos Beverages)                            | 820  |

2. Mallrat qe sipas shtojces 1 te Ligjit te aAkcizes 61/2012 jane ne listen S500 –Produkte te tjera qe permbajne alkool etilik:

- Ne cdo rast qe nje product i klasifikuar ne kapitujt 17 deri 22 duhet te paguaje akcize sipas percaktimeve te nenit 64 te ligjit te akcizes, ne kutine 37b te DAV duhet te vendoset kodi SSO.
- Nese nuk plotesohen percaktimet e nenit 64 te Ligjit te Akcizes per keto mallra vazhdohet procedura normale.

3. Kodet shtese BOP, W2P, W3P, IOP, S2P, T3P, T2P dhe T5P do te perdoren sipas specifikimeve te udhezimit nr. 04, date 28.09.2012

## **B. Kode procedure te zgjeruar**

Ne rastet kur kryhet nje hedhje per ne qarkullim te lire (IM4) me detyrime te paguara pervec akcizes, mallrat detyrimisht duhet te futen ne nje Magazine Fiskale.

Ne kete rast ne kutine 37 te DAV vendoset procedura e zgjeruar 4700 ose kombinime te 47 me kodet e regjimeve doganore nga te cilat dalin mallrat . Gjithashtu ne kutine 49 te DAV do te vendoset kodi i magazines fiskale me 13 karaktere ne te cilen do te futen mallrat.

Edhe per keto raste per kategorine e mallrave te meposhteme, ne kutine 37b do te vendosen kodet shtese si ne table:

| Kategoria<br>(sipas shtojces 1 te Ligjit te Akcizes 61/2012)            | Kodi shtese qe duhet<br>te vendoset ne<br>kutine 37b |
|---|--|
| W200<br>Vera e qete dhe pijet e qeta te fermentuara                     | W20  |
| W300<br>Vera spumante, Shampanja dhe pijet e fermentuara dhe te gazuara | W30  |
| I000<br>Pijet alkoolike te ndermjetme                                   | 100  |
| S200<br>Pije alkoolike (Spirituos Beverages)                            | S20  |

## **C. Njesite plotesuese**

Gjithashtu, me qellim llogaritje te detyrimeve, ne sistem jane shtuar disa njesi plotesuese. Plotesimi i tyre duhet te behet i sakte dhe me te dhenat si me poshte:

**PPA**-Perqitje alkool i paster—do te vendoset forca al koolike e mallit te deklaruar

**PKB**—Bitum kilogram i paster— vendoset bitumi i paster ne kg qe permban mall i deklaruar

**PPK**-Perqindje kafe e paster-vendoset perqindja e kafes qe permban mall i deklaruar

**LPA**- Litra alkool i paster—vendosen litrat e alkoolit te paster qe permban malli i deklaruar

**SPV**—Sasia e prodhimit vjetor-vendoset prodhimi ne hektolitra nga prodhuesi i huaj bazuar ne vertetimin e prodhuesit.

**Shenim:** Bazuar ne udhezimin e Ministrit te Financave nr 20, date 28.09.2012 "Mbi percaktimin e standarteve te dokumentit per vertetimin e sasise se prodhimit per qellime te percaktimin te nivelit te detyrimit te akcizes" ne rastet kur nuk ka vertetim nga prodhuesi **do te vendoset niveli me i larte i prodhimit vjetor ne bektolitra** qe percaktohet ne shtojcen 1 te Ligjit te Akcizes per ate kategori mallrash.

Te merren masa per njohjen te personelit doganor dhe agjensive doganore.

**Flamur GJYMISHKA**  
**DREJTOR I PERGJITHSHEM**